ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 23.07.2021 morri

VENDIM

Veprimi i KSHPK -së pas lëndës së formuar sipas denoncimit me numër 12-4441 / 1 të datës 30.12.2020 të paraqitur në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga parashtrues i njohur - Byroja e Prokurimit Publik, e cila gjithashtu i nënshtrohet veprimit kompetent denoncim anonim për paligjshmëri gjat realizimit të kontratës të prokurimit publik. NDËRPRITET

Në përputhje me dispozitatë e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pas kontrollimit të përmbajtjes së denoncimit dhe dokumentacionit shtesë, përcaktoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës për arsye se nuk janë përcaktuar pohimet nga denoncimi.

Lënda me numër 12 –4441/1 të datës 30.12.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4441/1 të datës 30.12.2020 është formuar në bayë të denoncimit të marë nga parashtrues i njohur - Byroja e Prokurimit Publik, e cila gjithashtu i nënshtrohet veprimit kompetent denoncim anonim për paligjshmëri gjat realizimit të kontratës të prokurimit publik.

Në denoncimin që është dorëzuar në shtojcë, tregon dyshim për paligjshmëri në realizimin e kontratës së prokurimit publik për sigurimin fizik me numrin e njoftimit -------------------- / 2020 lidhur ndërmjet ISHP ----------------------------------------- me personin juridik -------------------- DOOEL. Sipas pohimeve nga denoncimi, në shpalljen ishte planifikuar të punohej me 11 ekzekutues, gjegjësisht 3 persona në turn, por ajo kryhet me 7 persona, pra 1 person në turn.

Për të verifikuar pohimet dhe për të vërtetuar plotësisht gjendjen faktike në rastin e hapur, dhe duke pasur parasysh se sipas Ligjit për Prokurimin Publik, organi kontraktues është i detyruar të kontrollojë nëse ekzekutimi i kontratës së prokurimit publik ose marrëveshjes kuadër është në në përputhje me kushtet e kontratës, KSHPK i kërkoi organit kontraktues që të dorëzojë informacione në shtojcë dëshmitë e për realizimin e kontratës së prokurimit publik. Në të njëjtën kohë, KSHPK inspektoi dokumentacionin e tenderit, i cili është publikisht i disponueshëm në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik (SEPP), dhe në bazë të të cilit u përfundua kontrata e prokurimit publik e treguar në aplikim.

Organi Kontraktues, ISHP -------------------------------------------- -----------------, brenda afatit të përcaktuar me ligj, dorëzoi përgjigje ndaj kërkesës së KSHPK-së, me dokumentacionin në shtojcë për realizimin e kontratës në fjalë (vendim për krijimin e komisionit për ekzekutimin cilësor të kontratës për prokurimin publik, faturat, procesverbalet dhe oraret). Në të njëjtën kohë, me shkresën e informon KSHPK -në se në këtë rast konstaton se kontrata është përmbushur plotësisht në të gjitha dispozitat e saj nga mbajtësi i prokurimit dhe se nuk ka asnjë dispozitë në kontratë që thekson punën e tre personave me turne, ndërsa dispozitat tjera janë përmbushur plotësisht, gjë që është e qartë nga dokumentacioni i detajuar i bashkangjitur i shkresës.

Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës në përputhje me nenin 17 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktitë të interesave, për arsye se pohimet nga denoncimi nuk janë vërtetuar.

Duke pasur parasysh të theksuaren më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/19), vendosi si në dispozitën të këtij vendimi.

Përgatiti: M.r B.K.SH, Këshilltar
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska